



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr. 2326, datë 28.06.2013**

**Për**

***“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për implementimin e tarifës lokale të terminimit midis Abcom sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”***

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Znj. Alketa	Mukavelati	Kryetare
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Elkeda	Domi	Anëtare
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 28.06.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”), ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Fillimi i procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për implementimin e tarifës lokale të terminimit midis Abcom sh.p.k. - Albtelecom sh.a.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 88, neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (***Ligji nr. 9918***);

2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP” (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 i ndryshuar,

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e sipërmarrësit Abcom sh.p.k. me nr. 57Prot, datë 20.2.2013 (nr. 372Prot., i AKEP, datë 20.2.2013) “*Paraqitja e mosmarrëveshjes midis Abcom sh.p.k. dhe Altelecom sh.a. për implementimin e tarifës lokale të terminimit*”;
- Shkresa e Abcom sh.p.k. me nr. 77Prot. datë 5.3.2013 (nr. 372/2Prot. i AKEP, datë 6.3.2013) “*Kthim përgjigje tuajës nr. 372/1, datë 28.2.2013, mbi paraqitjen e mosmarrëveshjes midis Abcom dhe Altelecom për implementimin e tarifës lokale të terminimit*”;
- Shkresa e Abcom me nr. 866Prot, datë 28.9.2012, “*Dërgohet draft amendamenti i MI mes Altelecom dhe Abcom datë 30.6.2011*”;
- Shkresa e Abcom nr. 21Prot, datë 21.1.2013, “*Dërgohet draft amendamenti i MI mes Altelecom dhe Abcom datë 30.6.2011*”;
- Shkresa e Altelecom sh.a. me nr. 315/1Prot., datë 14.2.2013 “*Sqarim mbi shkresën tuaj (Abcom) datë 21.1.2013*”;
- Procesverbal i takimit të datës 25.3.2013;
- Shkresa e AKEP me nr. 692/1Prot. datë 19.4.2013, drejtuar Altelecom dhe Abcom;
- Shkresa e Altelecom me nr. 1738Prot., datë 29.4.2013, drejtuar Abcom “*Përgjigje tuajës datë 9.4.2013*”;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**),

si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R R E N :

Abcom sh.p.k. me shkresën nr. 57Prot, datë 20.2.2013 shpjegon se ka shtrirë aktivitetin e tij në shumë qytete dhe rajone të vendit. Prej më se dy vjetësh Abcom krahas Tiranës,

Shkodrës, Vlorës ushtron veprimtarinë e tij edhe në qytetet Durrës, Elbasan dhe Lushnje. Së shpejti Abcom do të shtrijë veprimtarinë e tij edhe në qytetet e tjera të vendit.

Abcom informon se ka realizuar marrëveshje interkoneksioni me të gjithë OFNT në treg përfshirë edhe Albtelecom. Me Albtelecom ka implementuar MI për disa zona numerike dhe rajone duke përfshirë qytetet Tiranë, Shkodër dhe Vlorë në të cilat është implementuar tarifa lokale e terminimit në rrjetat respektive.

Abcom shpjegon se ky bashkëpunim nuk ka vazhduar për qytete e rajone të tjera të vendit. Albtelecom nuk i është përgjigjur kërkesave të ligjshme të Abcom për implementimin e tarifave sipas zonave dhe lidhjeve.

Abcom me shkresën nr. 886Prot. datë 28.9.2012 i është drejtuar Albtelecom-it duke kërkuar amendim të MI lidhur midis Abcom dhe Albtelecom për implementimin e tarifave lokale brenda të njëjtës zonë interkoneksioni, për qytetet Durrës, Elbasan dhe Lushnje. Albtelecom nuk i është përgjigjur kësaj shkrese.

Abcom me shkresën nr. 351Prot. datë 22.1.2013 ka përsëritur kërkesën dhe ka dërguar sërish draft amendimin e MI për implementimin e tarifave lokale.

Albtelecom sh.a. me shkresën nr. 351/1Prot. datë 14.2.2013 i është përgjigjur Abcom-it duke dhënë sqaruar se është duke implementuar teknologjinë e rrjetit NGN dhe aktualisht ndodhet në procesin e migrimit të rrjetit ekzistues TDM në teknologjinë IP dhe NGN, proces i cili është programuar të përfundojë në prill të vitit 2013. Implementimi i kësaj teknologjie do të shoqërohet edhe me ndryshime konceptuale të topologjisë dhe arkitekteturës së rrjetit të Albtelecom, rrjedhimisht edhe në skemën funksionale të interkoneksionit.

Albtelecom sh.a. shpjegon se AKEP ka filluar procedurat e rishikimit të Planit Kombëtar të Numeracionit (PKN) dhe me përfundimin e këtij procesi do të përcaktohet edhe struktura e ndarjes dhe funksionimit të zonave të tarifimit.

Kërkesa e Abcom sh.p.k. për implementimin e lidhjeve të interkoneksionit sipas zonave tarifore përkatëse për qytetet: Durrës, Lushnje dhe Elbasan do të duhet të rishqyrtohet në një kohë tjetër të mëvonshme, në kushte e rrethana të mirëpërcaktuara për strukturën e rrjetit të Albtelecom si dhe riorganizimin e PKN nga AKEP.

Ndodhur në një situatë të tillë Abcom konsideron të ezauruar përpjekjen e tij për zhvillim negociatash me Albtelecom dhe vlerëzon qëndrimin e Albtelecom në flagrancë të plotë me ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 dhe vendimet e AKEP.

Për sa më sipër Abcom sh.p.k. kërkon ndërhyrjen e menjëhershme të AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së krijuar midis Abcom dh Albtelecom, lidhur me tarifën e terminimit të thirrjeve lokale në rrjetet respektive.

Abcom, shpjegon se kjo ndërhyrje është emergjente për shkak se shtrirja e rrjetit të shërbimeve të Abcom në qytetet e sipërpërmendura është në rritje dhe humbjet që krijohen nga mungesa e implementimit të tarifës lokale të terminimit shkakton humbje të konsiderueshme.

AKEP më datë 25.3.2013, ftoi palët në takim për të diskutuar mbi kërkesat e ngritura nga Abcom mbi lidhjen e aksesit në pikat lokale (*Durrës, Lushnje dhe Elbasan*) të interkoneksionit të Albtelecom. Nga Albtelecom u theksua se janë në proces rishikimi/migrimi të rrjetit proces i cili ka kosto. Albtelecom u shpreh i gatshëm për gjetjen e zgjidhjes dhe do të shikonte dhe vlerësonte kërkesat e Abcom sipas efijences ekonomike.

Në përfundim të takimit, palët morën përsipër të vijojnë negociatat dhe shkëmbimin e dokumentacionit përkatës me qëllim rënien dakord për lidhjen e aksesit në pikat e kërkuara. Në lidhje me këtë proces, palët do të informonin AKEP brenda 10 ditëve.

Duke qenë se sipërmarrësit Abcom sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. megjithë përpjekjet e bëra edhe me ndërhyrjen e AKEP, nuk kanë arritur të bien dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis tyre, për sa i takon tarifës së terminimit të thirrjeve lokale. AKEP, në zbatim të nenit 120 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, në rastet kur ato lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij,

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918 i ndryshuar, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

### **V E N D O S:**

1. Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Abcom sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. në lidhje me tarifën e terminimit të thirrjeve lokale në rrjetet përkatëse.
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
  - Altin Rrapaj Kryetar
  - Jonida Gjika Anëtar
  - Ded Jakaj Anëtar
  - Esmeralda Dervishi Anëtar
  - Dritan Malaj Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara Abcom sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;

4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R E**  
**Alketa MUKAVELATI**

**ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Benon PALOKA
3. Elkeda DOMI
4. Zamira NURÇE